

Zyrës së doktoratave të Universitetit të Tetovës  
Këshillit mësimor-shkencor i Fakultetit juridik të Universitetit të Tetovës

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit juridik i Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 03.12.2019, solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional të dorëshkrimit të temës së doktoratës, me titull “**Mbrojtja e interesave të Shteteve të Bashkuara në radhë të parë**”, të kandidatit Mr. sc. Anthony Preston.

Në bazë të vendimit nr. 13-1641/2, të datës 03.12.2019, Komisioni në përbërje: 1. Prof. Dr. Fehari Ramadani, mentor, 2. Prof. Dr. Jusuf Zejneli, anëtar, 3. Doc. Dr. Ebrar Ibraimi, anëtar, 4. Prof. Dr. Drita M. Fazlija, anëtar dhe 5. Prof. Dr. Ferat Polisi, anëtar, pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit juridik i paraqet këtë

## R A P O R T

### për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

#### Të dhënat biografike të kandidatit:

Anthony William Preston është lindur më 17 prill 1988 në Chicago Illinois, SHBA, ku e ka kryer arsimin fillor dhe atë të mesëm.

Studimet themelore në drejtimin e administrimit të biznesit i ka regjistruar në vitin 2006 në Northern Illinois University, DeKalb, SHBA dhe i ka kryer në maj të vitit 2010, duke fituar titullin akademik: Bachelor i shkencave në fushën e biznesit. Gjatë periudhës së studimeve, ai një vit studimor e ka kryer në Romë të Italisë në fushën e biznesit ndërkombëtar. Përveç kësaj, si student, ai ka shfaqur përkushtim të gjerë akademik dhe shoqëror, duke iu besuar detyra e presidentit të asociacionit studentor për regjionin e Great Lakes-it në kuadër të Fakultetit të Biznesit të Northern Illinois University.

Pas kryerjes së studimeve themelore, z. Anthony Preston po të njëjtin vit i ka regjistruar studimet e ciklit të dytë të studimeve në nivelin master, fusha e administrim biznesit (MBA) në të njëjtin universitet. Gjatë studimeve ai ka punuar si ndihmës studentor në Zyrën e Dekanatit të Fakultetit të Biznesit, duke qenë përgjegjës për studentët e huaj dhe delegacionet ndërkombëtare. Ndërkohë z. Preston, në kuadër të bashkëpunimit ndëruniversitar midis NIU-së dhe Universitetit të Bordosë në Francë, ai realizon vizitë studimore në Bordo dhe në vitin 2011 ai i kryen me sukses të shkëlqyer studimet e masterit dhe pajiset me diplomë të dyfishtë nga Northern Illinois

University dhe Universiteti i Bordosë në fushën e administrimit të biznesit (MBA) dhe biznesit ndërkombëtar.

Menjëherë pas kryerjes së masterit, z. Preston, si student i dalluar, punësohet në Fakultetin e Biznesit në NIU, duke udhëhequr me programin global dhe ndihmës-drejtor i programit të masterit MBA. Në vitin 2014, ai emërohet drejtor i programit global në Fakultetin e Biznesit, duke punuar në rrjetëzimin e këtij fakulteti me fakultet simotra në mbarë botën. Në kuadër të këtij roli, z. Preston i mban meritat kryesore edhe me bashkëpunimit ndëruniversitar midis Northerbn Illinoi University dhe Universitetit të Tetovës.

Në vitin 2018, z. Preston emërohet drejtor ekzekutiv i programeve ndërkombëtare në nivelin master midis Fakultetit të Biznesit të NIU-së dhe fakulteteve simotra në Bogota të Kolumbisë dhe Nanjing në Kinë. Nga qershori i vitit 2020 ai e ushtron pozitën e ndihmës-dekanit të Fakultetit të Biznesit në NIU.

Studimet e doktoratës në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare ai i ka regjistruar në vitin akademik 2016/17 në Universitetin e Tetovës nën udhëheqjen e Prof. Dr. Fehari Ramadanit, duke i kryer me sukses provimet dhe konferencat doktorale, të parapara me Rregulloren për studimet e doktoraturës të Universitetit të Tetovës.

#### **Publikimet shkencore:**

##### **International Marketing Management**

Drug Deals: Measuring the Success of Global Pharmaceutical Alliances  
Sullivan, Coughlan, Preston

**March 2014**

##### **European Journal of Economics, Law and Politics**

Diplomacy in the Southern Balkans and the Impact of the Perceptions of Donald Trump by Balkan Born Citizens Living in the United States  
Przybyla, Preston

**June 2018**

##### **International Education and Research Journal**

Ohrid Framework Agreement from Inception to Now  
Preston, Przybyla

**August 2018**

#### **Pjesëmarrjet dhe referimet në konferencat shkencore:**

Pjesëmarrës: Chicago, Illinois, SILK Road Conference

**Maj 2011**

Pjesëmarrës: Chicago, Illinois, Business in Indonesia

**Gusht 2011**

Prezantues: DeKalb, Illinois, Organizational Leadership

**Tetor 2011**

Pjesëmarrës: Chicago, Illinois, SILK Road Conference

**Maj 2012**

|  |             |
|--|-------------|
| Pjesëmarrës: Chicago, Illinois, International Trade Association  | Janar 2013  |
| Prezantues: DeKalb, Illinois, Organizational Leadership  | Maj 2013    |
| Pjesëmarrës: Chicago, Illinois, Multinational Conference   | Maj 2013    |
| Pjesëmarrës: Chicago, Illinois, MBAA International Conference  | Mars 2014   |
| Pjesëmarrës: Chicago, Illinois, SILK Road Conference   | Maj 2014    |
| Prezantues: University of Illinois, Organizational Leadership  | Janar 2016  |
| Ligjërues vizitues: University i Tetovës   | Shkurt 2016 |
| Prezantues: SILK Road Conference   | Mars 2018   |
| Prezantues: Global Problems & Community<br>Praxis: Local, National, and International Approaches to Peace and<br>Transcultural Communication, Northern Illinois University | Prill 2018  |
| Ligjërues vizitues: University i Tetovës   | Shkurt 2019 |
| Prezantues: SILK Road Conference   | Mars 2019   |

**Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidati gjatë studimeve të doktoratës:**

Kandidati Mr. sc. Anthony Preston që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë e deri më sot ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të temës. Ai me sukses ka realizuar tre konferencat doktrate, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Gjatë kësaj periudhe ka botuar disa artikuj shkencor.

**Analizë e punimit: “Mbrojtja e interesave të Shteteve të Bashkuara në radhë të parë”**

Në këtë tezë disertacioni, me titullin *Mbrojtja e interesave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në radhë të parë*, kandidati Anthony Preston nga njëra anë ofron një analizë për ndërthurjet e brendshme politike-shoqërore të SHBA-ve, kurse nga ana tjetër shtjellon rolin e politikave të jashtme amerikane në parandalimin e konflikteve në vendet me probleme etnike dhe demokraci të brishtë.

Në mënyrë të veçantë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, SHBA-të, me aleatët e tyre përëndimorë qenë lokomotiva e proceseve politike për zhbërjen e tiranive në vendet e Lindjes së Mesme si në Irak, Libi, Afganistan dhe më gjerë, por edhe në vendet e ish-blokut sovjetik dhe në ish-Jugosllavi, ku pati një shpërthim të pakënaqësive të shtypura etnike ndër dekada me radhë.

Pasi bën një përshkrim të shkurtër të historisë së popujve të Ballkanit, kandidati analizon periudhën e viteve të 90-ta të shek. XX, kur dhe filloi të shembej komunizmi si sistem politik, në tërë rajonin e gadishullit mbizotëroi një kaos i paparë, i cili e ngjalli dukshëm identitetin kombëtar të popujve të ndryshëm dhe i çoi ato drejt një mëvetësimi. Ky proces mund të kishte pasoja të paparashikueshme, po të mos vihej në lëvizje faktori ndërkombëtar. Futja në lojë e SHBA-ve, tashmë si një fuqi e etabluar mbarëbotërore sheshoi rrënjët e gjata të miqësive historike të disa vendeve evropiane si franceze-sllave dhe i dha kahjen e duhur shtetndërtimit në Ballkanin Perëndimor, i cili në fund u kurorëzua edhe me shpalljen e pavarësisë së shtetit të Kosovës (2008).

Kjo tezë e doktoratës ka përmbajtjen, tetë krerë, pjesën përmbyllëse, bibliografinë dhe burimet e shfrytëzuara, si dhe shtojcën, ku jepen dokumente zyrtare dhe intervistat e plota të zhvilluara me personalitete politike vendore dhe ndërkombëtare.

**Kreu i parë** përbën kreun hyrës të tezës së doktoratës, në të cilin është arsyetuar motivimi i përzgjedhjes së temës, janë ideuar qëllimet e punimet, metodologjia dhe janë ngritur tezat hulumtuese.

**Kreu i dytë** është kryesisht një vështrim historik rreth ngritjes së SHBA-ve në një superfuqi botërore, duke filluar nga kohët më të hershme dhe deri në ditët e sotme. Gjithashtu në vija të shkurtra trajtohet përfshirja e saj në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore si dhe angazhimi i saj për respektimin e të drejtave të njeriut, ndërtimit të demokracisë dhe ruajtjen e paqes në vendet e ish-BRSS-së, Jugosllavisë dhe në Lindjen e Mesme.

**Kreu i tretë** trajton politikat e jashtme të SHBA-së dhe pikat kyçe në të cilat ajo mbështetet si interesat gjeostrategjike, respektimi i lirive themelore të njeriut, balancën e proceseve politike dhe ekonomike botërore, por edhe angazhimin e saj të drejtpërdrejtë në përmirësimin e padrejtësive historike ndaj popujve si shqiptarët, të cilët në të kaluarën ishin kurban i interesave të fuqive të mëdha.

**Kreu i katërt** trajton marrëdhëniet politike-shtetërore të SHBA-ve me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe synimin e tyre në funksionimin e shtetit ligjor, prosperitetit ekonomik, fjalës së lirë dhe respektimin e vlerës universale. Shkurtimisht, duke u mbështetur në Raportin e Departamentit të Shtetit, janë dhënë pikat kyçe të marrëdhënieve bilaterale midis SHBA-ve dhe vendeve të Ballkanit si: Kroacia, Bosnja, Serbia, Mali i Zi, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut.

**Kreu i pestë** trajton ndërhyrjen parandaluese politike-ushtarake të faktorit ndërkombëtar në luftën e Kosovës, duke iu qasur gjenezës së problemit, krijimit të rrethanave të rënduara politike, ndërhyrjen ushtarake nga ana e SHBA-ve dhe forcave aleate dhe mësimin e nxjerrë nga ky konflikt.

**Kreu i gjashtë** i qaset rindërtimit të pasluftës së Kosovës, angazhimit diplomatik ndërkombëtar në ruajtjen e vazhdueshme të paqes si dhe planit të Ahtisaar-it, i cili çoi deri në pavarësimin e shtetit të Kosovës.

**Kreu i shtatë** në fokus e ka Marrëveshjen e Uashingtonit të iniciuar nga ana e presidentit Trump, prapaskenat deri ta arritja e saj siç janë: Krijimi i Asociacionit të Komunave Serbe dhe ideja për korigjimin e kufijve me Serbinë, e cila u aktualizua në dy vitet e fundit.

**Kreu i tetë** i punimit paraqet pjesën empirike e punimit, në të cilin do të renditen rezultatet konkrete të hulumtimit, respektivisht të anketimit me qytetarët amerikanë se çfarë ata mendojnë për ndërhyrjen e SHBA-ve në Kosovë gjatë vitit 1999.

Punimi është konceptuar në atë mënyrë që të jetë i kapshëm jo vetëm për specialistët e fushës të politikave ndërkombëtare dhe konflikteve ndëretnike, por edhe për shtresat më të gjera të lexuesve, në veçanti, për studentët, analistët dhe opinionistët.

### **Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura:**

Sa i përket qasjes metodologjike të punimit, do të vihen në përdorim një numër konsistent i metodave të veçanta, me anë të të cilave mund të arrihet deri te njohja më e mirë e problematikës së politikave ndërkombëtare për shtetet multietnike, por edhe i vetë rrethanave shoqërore-politike në Kosovë dhe mbarë rajonin e Ballkanit. Metodatat, që do të vihen në përdorim, janë si më poshtë:

- Metodatat idiografike, të cilat luajnë një rol të veçantë të kuptimit nga brenda të shkaqeve të veprimit të aktorëve në kontekstin historik;
- Metodatat diskursive, të cilat, nga njëra anë, mund të përdoren që të bëhet sa më transparent konstruksioni gjuhësor i politikave ndërkombëtare, kurse nga ana tjetër analiza e diskursit e dekonstruktin realitetin kosovar dhe ballkanas dhe e zhvesh nga realiteti i përkthyer, i imponuar si një e vërtetë absolute për dekada me radhë.
- Metodatat normative, rolin e politikave globale nuk e sqarojnë drejtpërdrejt, megjithatë japin propozime konkrete dhe praktike për impaktin që kanë ato në arenën ndërkombëtare.
- Metodatat deskriptive, kanë një rëndësi të veçantë për përshkrimin e mbarë procesit dhe rolin e politikave ndërkombëtare në amortizimin e rrethanave politike në shtetet me demokraci të brishtë siç është Kosova dhe mbarë shtetet e rajonit të Ballkanit.
- Metodatat statistikore, e përshkruajnë në mënyrë shumë të saktë dhe korrekte fenomenin e apostrofuar.
- Metoda e vëzhgimit të drejtpërdrejtë, e cila do të jetë me rëndësi të veçantë në arritjen e rezultateve konkrete praktike.
- Metoda krahasuese, e cila për qëllim ka t'i krahasojnë analizat dhe rezultatet e ndryshme, që më në fund të mund të arrihet deri te njohuritë më solide të procesit të ndërhyrjes së politikave ndërkombëtare në një vend siç është Kosova dhe rajoni i Ballkanit dhe impakti pozitiv që rezulton nga kjo ndërhyrje.
- Metoda e intervistimit, e cila përmes intervistimit të personaliteteve pjesëmarrëse në procesin politik, qoftë vendore, rajonale apo të huaja, ndikon dukshëm në arritjen e rezultateve konkrete të hulumtimit.
- Metoda e anketimit, e cila, njëjtë si metoda e intervistimit, do të ndihmojë në mbështetjen e tezave të ngritura dhe arritjen e rezultateve konkrete të hulumtimit.

### **Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit:**

Natyrisht se secili studim ndërtohet, paraprakisht duke ngritur çështje problemore për një tematikë të caktuar. Në rastin konkret, për të analizuar politikat e brendshme dhe ato ndërkombëtare të SHBA-ve dhe rolin e tyre për parandalimin e konflikteve në shtetet me demokraci të brishtë dhe me probleme ndëretnike siç është Kosova dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, është dashur të mendohen mirë hipotezat që do të ngrihen, me qëllim që punimi të dalë sa më i plotë dhe i qartë. Hipotezat e ngritura janë si në vijim:

- SHBA-të janë superfuqi botërore dhe është e patjetërsueshme që ato të kujdesen për sheshimin e padrejtësive, zhbërjen e sistemeve totalitare dhe ndërtimin e paqes në rrafshin ndërkombëtar;
- Pavarësisht ndasive të mëdha të brendshme politike dhe shoqërore, SHBA-të kanë një traditë të madhe të homogjenizimit politik, i cili është unifikues sa u përket ndërhyrjeve ndërkombëtare;
- Ndërhyrja në amortizimin e rrethanave politike-shoqërore në vendet e ish-Jugosllavisë, sidomos në Kosovë, përlligjet ndërkombëtarisht, duke pasur parasysh represionin e madh të sistemit jugosllav dhe atij serb ndaj shqiptarëve të Kosovës, spastrimin etnik, cenimin e të drejtave elementare njerëzore dhe gjenocidin ndaj popullatës kosovare gjatë luftës së vitit 1999;
- Ndërhyrja ndërkombëtare me në krye SHBA-të, gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999 ka qenë e detyrueshme, nga njëra anë, për t'i ndalë në mbrojtje popullatës së pambrojtur civile nga ushtria dhe paramilitarët serbë dhe nga ana tjetër, për ta ruajtur imazhin tashmë të dëmtuar ndërkombëtar në luftën e Bosnjës, gjatë së cilës humbën jetë mbi 200 mijë civilë;
- Shpallja e shtetit të Kosovës (2008) që e arritura më e madhe e politikës së SHBA-ve në rrafshin ndërkombëtar, por edhe vënia e themelit të paqes së përhershme për mbarë rajonin e Ballkanit Perëndimor, i cili me të drejtë llogaritet si një 'fuqi baroti' shkaku i nacionalizmave të theksuara dhe interesave gjeostrategjike të fuqive të mëdha;
- Arritja e një marrëveshjeje të pritur midis Kosovës dhe SHBA-ve, me ndërmjetësimin e SHBA-ve do të vulosë fatin e Kosovës, shqiptarëve etnikë në rajon, por edhe të mbarë popujve tjerë të Ballkanit, si dhe do të sheshojë njëherë e përgjithmonë idetë nacionaliste, duke ia trasuar rrugën prosperitetit ekonomik, kulturor, arsimor dhe do të kontribuojë dukshëm në ndryshimin e perspektiva të të menduarit të gjeneratave të reja, të cilat duhet të shkëputen nga e kaluara e shpërfytyruar dhe të orientohen kah e ardhmja progresive.

### **Kontributet kryesore shkencore të kandidatit:**

Tema të cilën e ka punuar kandidati i takon periudhës së afërt prandaj, nuk është trajtuar gjerësisht nga studiuesit deri tani. Ky studim do të shërbej si nxitje në të ardhmen që kjo temë të hulumtohet më gjerësisht nga studiues të tjerë.

Kandidati ka shfrytëzuar burime relevante, dokumente, intervista me personalitete të njohura, të cilat e bëjnë temën të rezistueshme nga kritikrat shkencore. Ai ka bërë krahasim të burimeve të ndryshme, të cilave u është qasur në mënyrë shkencore.

E veçanta e kësaj teme qëndron në faktin se kandidati ka arritur të realizoj intervista me disa nga njohësit e mirë të ngjarjeve dhe zhvillimeve, të cilat trajtohen në temë.

**Hulumtime të mundshme në të ardhmen:**

Tema e doktoratës “**Mbrojtja e interesave të Shteteve të Bashkuara në radhë të parë**” është e gjerë dhe brenda saj janë trajtuar çështje të ndryshme, çka jep mundësi që në të ardhmen kandidati ose studiues të tjerë të trajtojnë çështje të veçanta.

Kandidati ka bërë përpjekje për të dhënë pasqyrë sa më të plotë të ngjarjeve, të cilat lidhen me temën. Puna e tij përbën kontribut të çmueshëm jo vetëm për fushën juridike, por edhe për historinë e marrëdhënieve amerikano-shqiptare të periudhës më të re. Prandaj, tema e tij mund të shërbej si pikënisje për thellimin e hulumtimeve për njërën ndër ngjarjet më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare.

**Vlerësim dhe rekomandim:**

Nisur nga vlerësimet e mësipërme Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoratës “**Mbrojtja e interesave të Shteteve të Bashkuara në radhë të parë**”, të kandidatit Mr. sc. Anthony Preston, ka nderin që t’i propozoj Këshillimit mësimor-shkencor të Fakultetit juridik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen publike të kësaj teme të doktoratës.

**Komisioni:**

1. Prof. Dr. Fehari Ramadani, mentor 
2. Prof. Dr. Jusuf Zejneli anëtar 
3. Doc. Dr. Ebrar Ibraimi anëtar 
4. Prof. Dr. Drita M. Fazlija anëtar 
5. Prof. Dr. Ferat Polisi, anëtar 

Tetovë, janar 2021